



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI
PYJOR/KULLOSOR PËR SIPËRFAQEN PYJORE E CILA DO T'U
NËNSHTROHET PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR.**

Subjekti "BAD" shpk ka paraqitur kërkesën pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqje nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes ku do të ndërtohet godina e Hec "Mazreka". Bazuar në ligjin 57/2020, datë 30.04.2024, si dhe në VKM nr 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjorkombëtar apo zgjerimin e tyre", si dhe në VKM nr 592, datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në Vendimin nr 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor" të ndryshuar, me anë të së cilës kërkon shprehjen e dakortësisë nga ana e Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor i sipërfaqes prej 0.08 ha që do të shërbeje për ndërtimin e veprës së marrjes dhe ndërtesës e Hec "Mazreka" nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

Subjekti "BAD" shpk ka paraqitur pranë Bashkisë Korçë kërkesën për marrjen me Qira të fondit kullor për ndërtimin e Hec "Mazreka" dhe bashkëngjitur kërkesës ka paraqitur dhe dokumentat si, Miratim Paraprak Nr. 8502/3, datë 03.09.2018 "Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, Hidrocentralit "Mazreka", në pellgun ujëmbledhës të lumit të Beçit, Qarku Korçë" dhe më Vendim 13, për VNM Paraprak me Nr. Prot 1000 Prot, datë 02.03.2020 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Autorizim për përdorim të burimit ujqor Nr prot 25/1, datë 25.01.2019 Miratuar me vendim të këshillit të basenit ujqor Seman Nr 24, datë 10.01.2019 nga Këshilli i Basenit Ujqor Seman, Kontratë për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Mazreka" me kapacitet 2000 kw, në pellgun ujëmbledhës të Lumit të Beçit, Qarku Korçë dhe bazuar në legjislacionin në fuqi në datën 29.07.2020 është lidhur me Bashkinë Korçë një Kontratë Qiraje me objekt Dhënien në Përdorim/Qira të Fondit Pyjor dhe Kullor publik për ndërtimin e HEC "Mazreka".

Ky subjekt ka aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga fondi kullor të sipërfaqes prej 0.08 ha në të cilën do të ndërtohet vepra e marrjes dhe ndërtesa e Hec "Mazreka". Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i është drejtuar Bashkisë Korçë më shkresën Nr 2510/3 Prot, datë 08.05.2024 për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi kullor të sipërfaqes prej 0.08 ha si dhe dakortësinë e Këshillit Bashkiak, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III, të VKM nr 888, datë 27.12.2022.

Nga ana e Sektorit të Pyjeve është përgatitur raporti tekniko-ekonomik dhe i është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën Nr 3728/1 Prot, datë 24.08.2017. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i është drejtuar me shkresën Nr. 9583 Prot, datë 13.12.2018 ku kërkon dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor.

Bazuar në VKM nr 592, datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në Vendimin nr 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor” të ndryshuar, si dhe në VKM nr 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” ku sipas pikës 2, shkronja d, kapitulli III, për vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullor kërkohet Miratimi me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor me vendim të Këshillit Bashkiak.

Bashkia Korçë mendon se ndërtimi i këtij HEC-i do të sjellë një përmirësim të dukshëm të situatës elektrike për këto fshatra.

Në këto kushte dhe bazuar në, Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin 10 083, date 23.02.2009, “Për miratimin e marrëveshjes së Koncesionit...”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...”, në VKM nr 592, datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në Vendimin nr 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor” të ndryshuar, në VKM nr 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjorkombëtar apo zgjerimin e tyre”.

I propozojmë Këshillit të Bashkisë të shprehë Miratimin për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor me vendim të Këshillit Bashkiak për sipërfaqen kullorë e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike
dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

**Drejtoria e Pyjeve
dhe Kullotave**

Johan Marko

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO